



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS
SEKTORI I PROKURIMEVE PUBLIKE

Nr. _____ Prot.

Patos, më 30/05/2025

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Shërbim printimi, mirëmbajtje e pajisjeve informatike, bojë dhe letër format për vitet 2025, 2026, 2027”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
Printime dhe shërbime të lidhura 79800000-2

VLERA E FONDIT LIMIT: 5,322,500 (pesë milion e treqind e njëzet e dy mijë e pesëqind) lekë pa TVSH, vënë në dispozicion nga të ardhurat lokale për vitin 2025, 2026, 2027.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Patos ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 10;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe nenit.

(shënim: plotësoni nëse është rasti, aktin konkret ligjor ose nëligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale në fjalë).

Sipas percaktimeve të bera në Shtojcën 8 të DST-ve (**Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/**

2.2.1 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë xhiron vjetore për vitet financiare 2022, 2023 dhe 2024, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e fondit limit**. *Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra vlerën e 40% të fondit limit, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të tre viteve financiare.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

$5,322,500 \times 40\% = 2,129,000$

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Vendosja e këtij kriteri behet me qëllim që Autoriteti Kontraktor të sigurohet për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nepermjet dokumenteve të kërkuara, se zoterojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur me sukses kontratën sic është parashikuar nga AK. Kriteri i mësipërm është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontratën, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare; si dhe nenin 13 të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për Tatimin Mbi të Ardhurat” i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për deklaratat individuale vjetore të të ardhurave; Njesia e prokurimit ka gjykuar të nevojshme përcaktimin e dy viteve të fundit në përputhje me vlerën e fondit limit të parashikuar.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet*

financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare; si dhe nenit 13 të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 "Për Tatimin Mbi të Ardhurat" i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për deklaratat individuale vjetore e të ardhurave.

2.2.2 Vërtetim lëshuar për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2024, kudo ku operatori ushtron aktivitet, sipas regjistrimit në QKB, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për vitin 2024.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anetar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia në të cilën është rregjistruar sipas QKB-se).

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore" i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

Referuar sa më sipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vërtetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore për vitin 2024 sipas kësteve prane bashkise/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për "Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e

aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

$$5,322,500 \times 20\% = 1,064,500$$

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe pikën 4/b të nenit 55 të VKM nr.285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën sa 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Vendosija e këtij kriteri behet me qëllim që Autoriteti Kontraktor të sigurohet për aftësinë teknike të OE ofertues, duke vërtetuar nepermjet përvojës së mëparshme, se zoterojnë kapacitet dhe aftësinë teknike për të përmbushur kontratën siç është parashikuar nga AK.

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të deklarojë nëpërmjet paraqitjes së një deklarate se merr përsipër të realizojë furnizimin dhe montimin e të gjitha pajisjeve objekt prokurimi (përfshirë kryerjen e shërbimit të transportit dhe montimit të të gjithë pajisjeve në ambjentet e Bashkisë Patos).

ARGUMENTIM: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 8 të nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Ky vetdeklarim kërkohet për të vërtetuar dhe garantuar AK-së produkte funksionale dhe realizimin me sukses të kontratës përsa i përket dorëzimit të mallrave objekt prokurimi.

Nisur nga rëndësia që ka objekti prokurimit për mbarëvajtjen e punës në institucion kërkohet ky kriter për ti ofruar siguri autoritetit kontraktor.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht 1 (një) person me kualifikimin** Inxhinier Elektronike ose Inxhinier informatike ose IT, (ose profil ekuivalent). Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

a. Inxhinier Elektronike ose Inxhinier informatike ose IT, (ose profil ekuivalent). 1 (një)

Per kete duhet te paraqes Diplome, CV, kontrate pune te vlefshme, dhe te figuroj ne listpagesen e shoqerise nga muaji Dhjetor 2024 e ne vazhdim. në fazën e ofertimit Operatori ekonomik plotëson formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Stafi që do të deklarohet detyrimisht do ti paraqitet Autoritetit Kontraktor për të genë pjesë e planit të zbatimit të kontratës.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kërkesa e punonjësve është bërë për arsye të domosdoshmërisë në montimin, instalimin, konfigurimin dhe riparimin e pajisjeve në rastet e difekteve të mundëshme që mund të ndodhin gjatë përdorimit.

2.3.4. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

- Automjet

copë 1

Pranohet marrja me qera e mjeteve të mësipërme, me kusht që kontrata e qeramarrjes të jetë bërë para noterit.

Ofertuesi për makineritë, të cilat janë në pronësi ose qera (me kontratë noteriale), duhet të paraqesë, dokumentacionin e mëposhtem:

- lejen e qarkullimit.
- certifikatën e pronësisë,
- siguracionin e mjetit,
- kolaudimin,
- certifikatë transporti (në rastin kur është e aplikueshme)
- fotografi të mjetit të paraqitur. (të cilat duhet të jenë në emër të shoqërisë ose në emër të qeradhënësit).

Për mjetet dhe pajisjet të cilat nuk kanë leje qarkullimi, ofertuesi duhet të paraqesë:

- kontratë noteriale të blerjes,
- fatura tatimore të blerjes ose dokumenta zhdoganimit të mjetit.
- a) *Për mjetet që shënohen në regjistra publike duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit, , leje qarkullimi, plus certifikatën e kontrollit teknik , siguracionin e mjetit (të vlefshme), dhe për mjetet e siguruar me qera, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij, leje qarkullimi, plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit,(të vlefshme), të shoqëruar me kontratën përkatëse të qerasë/furnizimit noteriale,, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.*
- b) *Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.*

Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Automjeti kërkohet për arsye të transportit të pasjisjeve në momentin e parë që do të kryhet montimi dhe instalimi i pasjisjeve por edhe në rastet e difekteve të mundëshme që operatori ekonomik duhet ta mari pajisjen dhe ta shpjer për riparimet e nevojshme.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës të deklarojë se riparimi i pajisjes së difektuar do të riparohet brenda 24 orë nga njoftimi, në çdo vend të instalimit të pajisjes.

Argumentimi: Në bazë të nenit 41, pika 6), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku Autoriteti kontraktor, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

Nisur nga rëndësia që ka objekti prokurimit për mbarëvajtjen e punës në institucion kërkohet ky kriter për ti ofruar siguri autoritetit kontraktor.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesi Katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit si dhe skedën teknike për listën e mësipërme, në të cilët të tregohen dhe specifikohen qartë materialet që do të ofrohen, në rastin kur janë në gjuhë të huaj ato duhet të përkthehen dhe noterizohen në gjuhën shqipe.

- Pajisje Multifunkionale (Printer, Fotokopje, Skaner) Formati A3 dhe A4 - Bardh e zi
- Pajisje Multifunkionale (Printer, Fotokopje, Skaner) Formati – A4 – Bardh e zi
- Pajisje Multifunkionale (Printer, Fotokopje, Skaner) Formati – A3 dhe A4 – Color
- Pajisje Multifunkionale (Printer, Fotokopje, Skaner) Formati – A4 – Color

Argumentimi: Në bazë të nenit 41, pika 6), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku Autoriteti kontraktor, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

Nisur nga rëndësia që ka objekti prokurimit për mbarëvajtjen e punës në institucion kërkohet ky kriter për ti ofruar siguri autoritetit kontraktor si dhe për ti ofruar pajisje funksionale për realizimin e shërbimit.

Specifikime teknike

Për te realizuar sistemin e shërbimit te printimit/fotokopjimit/skanimit kërkohen sasia e pajisjeve te mëposhtme.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Për te realizuar sistemin e shërbimit te printimit/fotokopjimit/skanimit kërkohen sasia e pajisjeve te mëposhtme:

Pajisje Multifunkionale (Printer, Fotokopje, Skaner)

Formati – A3 dhe A4; Bardh e zi Sasia 4 Cope

Teknologjia	Lazer/Bardhe zi
Shpejtesia	Jo me e vogel 30 faqe/min
Resolucioni i printimit	Jo me i vogel 600 x 600 dpi
Kapaciteti mbajtes i sirtareve	Jo me i vogel 500 faqe
Kapaciteti ne dalje	Jo me i vogel 300 faqe
Madhesia e letres	A6-A3
Memorja	2 GB / 320 GB HDD
Lidhja	Ethernet, USB
Skanimi	Full Network color Scan (Scan to e-mail, scan to folder, Scan to FTP, scan to USB, Scan to SD Card)
ARDF	50 faqe
Printimin ne te dyja anet (Duplex)	Po

Pajisje Multifunkionale (Printer, Fotokopje, Skaner) Formati – A4 – Bardh e zi Sasia 8 cope	
Teknologjia	Lazer/Bardhe zi
Shpejtesia	Jo me e vogel 30 faqe/min
Resolucioni i printimit	Jo me i vogel 600 x 600 dpi
Kapaciteti mbajtes i sirtareve	Jo me i vogel 300 faqe
Kapaciteti ne dalje	Jo me i vogel 200 faqe
Madhesia e letres	A6-A4

Memorja	Min 1024 MB
Lidhja	Ethernet, USB
Skanimi	Full Network color Scan (Scan to e-mail, scan to folder, Scan to FTP, scan to USB, Scan to SD Card)
ARDF	30 faqe
Printimin ne te dyja anet (Duplex)	Po

Pajisje Multifunksionale (Printer, Fotokopje, Skaner)

Formati – A3 dhe A4 – Color Sasia 2 cope

Teknologjia	Lazer/Me ngjyra
Shpejtesia	Jo me e vogel 20 faqe/min
Resolucioni i printimit	Deri në 1200 x 1200 dpi
Kapaciteti mbajtes i sirtareve	Jo me i vogel 500 faqe
Kapaciteti ne dalje	Jo me i vogel 200 faqe
Madhesia e letres	A6-A3
Memorja	2 GB / 320 GB HDD
Lidhja	Ethernet, USB
Skanimi	Full Network color Scan (Scan to e-mail, scan to folder, Scan to FTP, scan to USB, Scan to SD Card)
ARDF	50 faqe
Printimin ne te dyja anet (Duplex)	Po

Pajisje Multifunkionale (Printer, Fotokopje, Skaner) Formati – A4 – Color Sasia 2 cope	
Teknologjia	Lazer/Me ngjyra
Shpejtesia	Jo me e vogel 20 faqe/min
Resolucioni i printimit	Jo me i vogel 600 x 600 dpi
Kapaciteti mbajtes i sirtareve	Jo me i vogel 500 faqe
Kapaciteti ne dalje	Jo me i vogel 200 faqe
Madhesia e letres	A4
Memorja	2 GB / 320 GB HDD
Lidhja	Ethernet, USB
Skanimi	Full Network color Scan (Scan to e-mail, scan to folder, Scan to FTP, scan to USB, Scan to SD Card)
ARDF	50 faqe
Printimin ne te dyja anet (Duplex)	Po

- **Software për menaxhimin dhe monitorimin e pajisjeve te printimit dhe shërbimit.**

Menaxhimi dhe kontrolli i realizimit te shërbimit në sasi e cilësi do të bëhet me pajisje **Software**. Për software të menaxhimit te pajisjeve të printimit, operatori duhet të ketë akses vetëm në shikimin e numrit të faqeve të printuara dhe fotokopjuara, ndërkohë që do të jetë Sektori Ekonomik, që do të bëjë menaxhimin e dokumentave të fotokopjuara dhe skanuara.

	Software për monitorimin dhe menaxhimin e pajisjeve te printimit
1	Monitorimin i statusit te pajisjeve ne kohe reale.

2	Menaxhimin dhe konfigurimin e pajisjeve ne mënyrë te centralizuar. Krijimi i profileve te ndryshme te printimit, skanimit me ane te software dhe shpërndarjen e konfigurimit te te gjithë pajisjet, një grup apo disa pajisje ne mënyrë automatike.
3	Raportim me e-mail për sasinë e printimeve te secilit user (nëse aplikohet), te gjithë pajisjeve apo nje grupi te tyre.
4	Menaxhimin e pajisjeve me usera (nëse kërkohet) dhe konfigurimet përkatëse ne mënyrë te centralizuar.
5	Ruajtja e raporteve ne server ne mënyrë periodike (ditore, javore, mujore, vjetore).
6	Dërgimi i e-mail automatike ne rast te shfaqjes se problemeve teknike.
7	Dërgimi i e-mail automatike qe tregon statusin e tonerit dhe lajmërimi për ndërrimin e tij ne mënyrë proactive.
8	Krijimi i raporteve për sasinë e printimeve, fotokopjimeve, skanimeve për secilin user, departament, drejtori...etj.
9	Software duhet te ruaje ne databaze te gjithë aktivitetin e pajisjes dhe te mundësoje krijimin e raporteve mbi baze pajisjesh apo grupi pajisjesh. Krijimin e raporteve për kohen qe pajisjet kane ndenjur pa pune për arsye te problemeve teknike, krijimin e raporteve për kohen e shfaqjes dhe zgjidhjes se një problemi teknik dhe shpjegimin e natyrës se problemit te shfaqur.
10	Aplikacion Android dhe IOS për monitorimin e statusit te pajisjeve dhe lidhja e tij me software.
11	Mundësimi për upgrade automatic me ane te software te versioneve te fundit te firmwareve te pajisjeve.
12	Pull dhe secure printing te implementohet ne pajisjet qe kërkohet.
13	I gjithë sistemi duhet te jete automatik dhe te monitorohet nga një qendër e vetme.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet teknike janë hartuar nga drejtoria e burimeve njerezore, janë konceptuar nga specialisti i IT-së pranë institucionit Bashkia Patos në përputhje me objektin e prokurimit dhe nevojat e autoritetit kontraktor.

Shënim:

Referuar udhëzimeve të APP, për zërat në DST që mund të jete paraqitur marke/brand, operatorët ekonomik mund të ofertojnë ekuivalente të tyre gjatë përgatitjes së ofertës ekonomike. Në përfundim, Njësia e Prokurimit vendosi unanimisht miratimin e dokumenteve të tenderit dhe si afat përfundimtar për dorëzimin e ofertave përcaktoi datën 12.05.2025, ora 11:00.

NJËSIA E PROKURIMIT

Shkëlqim Xhaferi

Florian Kita

Mitjon Nikolla